

VENDIM
Nr. 570, datë 22.7.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 446, DATË 22.5.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË
PERSONELIT TË POLICISË SË SHETËTIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 19, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të aktit normativ nr. 28, datë 2.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 88/2019, ‘Për buxhetin e vitit 2020’, të ndryshuar”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 446, datë 22.5.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... 11 058 (njëmbëdhjetë mijë e pesëdhjetë e tetë) punonjës ...”, zëvendësohen me “... 11 645 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë) punonjës ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama